



KËSHILLI I QARKUT TIRANË

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Specialist për Burimet Njerëzore në Drejtorinë Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë

Lloji i Diplomës: shkenca shoqërore dhe komunikimi/ matematikë dhe informatikë/

Niveli diplomës "Master Profesional"

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" (*indryshuar*), si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr.243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Tiranë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin:

- **1 (një) Specialist për Burimet Njerëzore, në Drejtorinë Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, kategoria IV-a**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE:

9 dhjetor 2016

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIM CIVIL:

14 dhjetor 2016

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Specialisti për burimet njerëzore përgjigjet tek Drejtori Juridik, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në realizimin e funksioneve të veta për çështjet që lidhen me burimet njerëzore duke përfshirë administrimin e dokumentacionit për planifikimin e nevojave për personel, procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, disiplinës në punë, trajnimit, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për shërbimin civil. Mban dokumentacionin dhe përgatit raportet për eprorin direkt dhe Sekretarin e Përgjithshëm lidhur me administrimin e dosjeve të personelit administrativ të institucionit. Ndiemon në përditësimin e të dhënave në databasen e programeve për menaxhimin e burimeve njerëzore e-pav dhe hrmis. Mirëmban dhe ngarkon në sistem cdo dokument lidhur me dosjet e personelit administrativ.

1 LËVIZJAPARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Profesional” në fushën e, shkenca shoqërore dhe komunikimi/ matematikë dhe informatikë/ dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (*për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*);
- b- Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (word, excel, internet);
- c- Të zotërojnë çertifikatë për njohjen e gjuhës angleze (TOEFEL ose IETLS).

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhëzime-manuale/60-jetëshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i dokumentave për levizjen paralele duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (– Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **9.12.2016.**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.12.2016** Drejtorja Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Drejtorja Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

Në përfundim të vlerëimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë proçedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në "Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit" në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke filluar nga data 15.12.2016.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesa të përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit Nr.152/2013“Për nëpunësin civil”(i ndryshuar).

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Profesional” në fushën e shkencave shoqërore dhe komunikimi/ matematikë dhe informatikë/ dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit);
- b- Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (word, excel, internet);
- c- Të zotërojnë certifikatë për njohjen e gjuhës angleze (TOEFEL ose IETLS).

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.

- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *(për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit);*
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit(ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dorëzimi i dokumentave për pranimin në shërbimin civil duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **14.12.2016.**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **15.12.2016**, Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **60 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **25 pikë**;
- c- Jetëshkrimin,që konsiston në vlerësimin e arsimimit,të përvojës e të trajnimeve,të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tirane si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk”, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi,

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë duke filluar nga data 15.12.2016 si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Atatürk”.

Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore